

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.643/16

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Gjyqtari** i vetëm gjykues Gëzim Ademi, me procesmbajtësen Hasnije Muhaxheri, në çështjen penale ndaj te pandehurve: V.H me vendbanim ne Lagjen ..., banesa nr. ... - ..., si dhe F.N me vendbanim ne ... rr. "... " nr. ..., për shkak te veprës penale: Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me nenin 31 KPRK-se, sipas aktakuzës te Prokurorisë Themelore ne Mitrovice- PP.II.nr.25/2016 te datës 19.09.2016 pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te dt. 15.02.2019, ne mungese te prokurores Natasha Taniq, ne prezence te te pandehurve e te njëjtën dite publikisht shpall ketë, ndërsa me dt.13.03.2019 përpiloi ketë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri: V.H , nga i ati S., e ëma S., e gjinisë Sh., i lindur me ... ne fsh. ... KK. ..., tani me vendbanim ne Lagjen ..., banesa nr. ... - ... , me numër personal ..., Shqiptar, Kosovar , i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë, ka te kryer shkollën e mesme.**

**I pandehuri: F.N , nga i ati A., e ëma H., e gjinisë R., i lindur me ..., ne ... KK. ..., tani me vendbanim ne ..., rr. "... " nr. ... me numër personal ..., shqiptar, Kosovar, i pa punë, i martuar baba i një fëmije, i gjendjes se dobët ekonomike.**

**JANE FAJTOR**

**SEPSE:** me dt. 31.12.2015, rreth orës 19:05 min. ne rr. "... " ne ... te dyshuarit pas një mosmarrëveshjeje qe kishin me te dëmtuarin Sh.A e kane goditur me grushta dhe shkelma, neper pjese te ndryshme te trupit, nga te cilat goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore dhe atë: ndrydhje te indeve te buta ne regjionin e kokës dhe regjionin e gjoksit, gërvishtje ne regjionin e majtë ballor te kokës dhe regjionin e dorës se majte, thyerje e brinjëve VIII dhe IX te anës se majte te gjoksit, lëndime këto qe bëjnë pjese ne grupin e dëmtimeve te renda trupore, me pasoja t përkohshme për shëndet.

Me këtë ne bashkryerje kane kryer veprën penale: **Lëndim i rend trupor nga neni 189 par 1 e pika 1.3 e lidhur me nenin 31 te KPRK.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,21,41,45,73, dhe 189 par 1 pika 1.3 e lidhur me nenin 31 te KPRK -se, dhe nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës i:

**GJYKON**

### **1. Te Pandehurin: V.H**

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej tre (3) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

### **2. Te Pandehurin: F.N**

Me dënim burgu ne kohëzgjatjeje prej tre (3) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

OBLIGOHEN te pandehurit, qe ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 10.00€, ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguajnë secili veq e veq shumen prej 15 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimet te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 15 euro te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguajnë ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike -kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

**Prokuroria Themelore ne Mitrovice** - ka ngritur aktakuze PP.II.nr.25/2016 te datës 19.09.2016, kundër të pandehurve V.H me vendbanim ne Lagjen ..., banesa nr. ...- ..., si dhe F.N me vendbanim ne ... rr. "... " nr. ..., për shkak te veprës penale: Lëndim i rend trupor nga neni 189 par.1 pika 1.3 e lidhur me nenin 31 KPRK-se.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë te pandehurit: V.H deklaroi se e ndjen veten fajtor për veprën penale dhe njëherit i vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe i premtoj gjykatës se nuk do te kryej vepra tjera penale dhe te njëjtin e kemi familjar dhe nga këto arsyeje i vjen shume keq, ka qene një moment aty për aty dhe pas tri dite jemi pajtuar mes veti, dhe me te dëmtuarin ne vazhdimisht mbajmë raporte te mira. Po ashtu edhe F.N deklaroi se e ndjen veten fajtor për veprën penale qe me vihet ne barre, e aç me shume pasi qe ne jemi bagjanak- bashkëshortet i kemi motra, ne vazhdimisht shkojmë e vijmë te njeri tjetri dhe kemi raporte te mira.

Prokurorja lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi: se e pranoj pranimin e fajësisë për te dy te pandehurit, nga se te njëjtit pranimin e fajësisë e kane dhen ne mënyrë vullnetare dhe se te njëjtit e kane pranuar fajësinë sipas shkresave dhe fakteve qe gjenden ne lende dhe atë i propozoj gjykatës se me rastin e shqiptimit te dënimit ta merr parasysh si rrethane lehtësuese gjate marrjes se shqiptimit te dënimit kundër V.H dhe F.N.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi qe te pandehurit kuptuan natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë te pandehurit e bënë në mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike qe do të bënin të pamundur që gjykata të beje vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga te pandehurit është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, e

që konkretisht mbështetet ne provat materiale si; Raporti Policor ..., deklaratat e te pandehurve, deklarata e te dëmtuarit, dëshmitë e dëshmitareve S.Sh, S.H, S.A dhënë ne polici, raportet mjekësore ne emër te dëmtuarit, ekspertizat mjeko-ligjore e lëshuar nga eksperti mjeko-ligjor N.U me dt. 26.07.2016, të gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes së akuzës njëkohësisht janë me përputhjen e pranimit të fajësisë nga te pandehurit, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurve.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke u bazuar ne nenin 73 te KPRK-se, ashtu qe kjo gjykatë pate parasysh lartasin e dënimit qe për këtë vepër penale minimumi i dënimit është 6 (gjashtë) muaj ndërsa maksimumi i dënimit për këtë vepër penale është 5 vite, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale për te dy te pandehurit gjë qe nga provat rezulton se te pandehurit këtë vepër e kishin kryer me dashje drektë e qe është shkalla me e larte e përgjegjësisë penale, po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese për te dy të pandehurit edhe faktin se te njëjtit janë te njohur për policin sipas shkresës mbi informacionin nga policia ku sipas tij te pandehurit evidentohen për vepra penale te natyrës se njëjtë dhe te ndryshme, po ashtu gjykata morri faktin se i dëmtuari ishte goditur ne shtëpinë e vete ne prezence te familjes nga ana e te pandehurve, po ashtu gjykata murre parasysh edhe faktin se këto vepra penale janë ne rritje permanente. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësve dhe sjelljet e tyre pas kryerjes së veprës penale, ndërsa për veç kësaj gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tyre me rastin e pranimit të fajësisë rezulton se e ndien vetën fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurve për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tyre për veprën penale.

Nga gjitha këto gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurve pasi që për gjykatën në rrethana te tilla mjafton se me shqiptimin e këtij dënimi do te arrihet qëllimi i dënimit qe te parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen si dhe ti parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe kompensimin e viktimave për humbjen ose demin e shkaktuar nga vepra penale, si dhe një kohësisht ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes se dënimit, bazuar ne nenin 75 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i KPRK-ës, ku kjo dispozite ka parapare se ndaj te pandehurit qe ka pranuar fajësinë gjykata munde te aplikoj dispozitat zbutjes se dënimit, prandaj kjo gjykate duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit i ka shqiptuar dënimin me burgim nen minimumin e veçantë ashtu qe ka caktuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 3 muaj ndaj te pandehurve, ashtu qe gjykate vlerëson se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënimit ndaj te pandehurve.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që ti obligoj te pandehurit qe te paguajnë për ekspertizën mjeko-ligjore te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 10 €, ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguajnë secili veq e veq shumen prej 15 Euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e

viktimave te krimet te paguajnë secili veq e veq shumen prej nga 15 euro te cilat shpenzime te pandehurit janë te obliguar qe ti paguajnë ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarin e ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.643/16 dt.13.03.2019**

Procesmbajtësja:  
Hasnije Muhaxheri

**Gjyqtari i Vetëm Gjykues**  
Gezim Ademi

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine- nëpërmes kësaj gjykate.